



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:037739

Datë: 24.03.2021

Numri i dokumentit: 01629719

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.101/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA VUSHTRRI, Departamenti i Pergjithshem - Divizioni Penal, gjyqtari Ferki Xhaferi me procesmbajtësen praktikanten Xheneta Kurti, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit B. S., për shkak të veprës penale “ Vjedhje e Sherbimeve“ nga neni 314 par.6, lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II-nr.411/21 të datës 25.02.2021 dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor të paraqitur nga Prokuroria me datë 25.02.2021, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, në mbështetje të nenit 495 të KPPK-së, me datë: 08.03.2021, nxjerre këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II-nr.411/21 të datës 25.02.2021 andaj gjykata konform nenit 495 të KPRK-së jep:

URDHËRI NDESHKIMOR

I PANDEHURI: B. S. nga i ati A. i lindur me, tash jeton në fshatin S., komuna Vushtrri, me numër personal ID1..., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE: nga data e pavërtetuar deri më 10.11.2020 në shtëpinë e tij në fshatin S., komuna e Vushtrrisë, ku nga personat e autorizuar të KEDS-it u konfirmu, me qëllim të përfitimit të paligjshëm dobisë pasurore për vete, pa autorizim përdori shërbimet e furnizimit me energji elektrike për të cilat dinte se janë në këmbim të pagesës, në atë mënyrë duke lidhur një kabllo direkt jashtë pikës matëse jashtë njëhësorit, pa njëhësor nr.... nuk regjistroj konsumin e energjisë elektrike, duke shkaktuar kështu dëme materiale KEDS-it në shumë prej 320,24 euro sipas kalkulimit të bërë nga personat të autorizuar të KEDS-it.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në mbështetje të dispozitave, të neneve, 4, 7, 17, 21,38, 40, 43, 48, 69, 70, 314 të KPRK-se, dhe neneve 365, 493, 495, 496, të KPPK-së, shqipton:

DENIM ME KUSHT

Me te cilin të pandehurit B. S. i vërtetohet dënimi me gjobë në shumë prej **200(dyqind)euro** i cili dënimi nuk do të ekzekutohet në afat prej një viti në qoftë se i njëjti nuk kryen veprën tjetër penale.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale –paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DETYROHET i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-se të paguaj dëmin e shkaktuar në shumën prej 320,24 euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzë PP.II-nr.411/21 të datës 25.02.2021, ndaj të pandehurit B. S. “ Vjedhje e Shërbimeve “ nga neni 314 par 6, lidhur me par. 1 të KPRK-së. Gjithashtu, kjo prokurori ka bërë kërkesë për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor me datë 25.02.2021, ndaj të pandehurit B. S. për veprën penale “ Vjedhje e Shërbimeve “ nga neni 314 par 6, lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe atë shqiptimin e dënimit me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata shqyrtoj aktakuzën, kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, provat dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara, në përputhje me nenin 495 të KPP-së, dhe se janë plotësuar kushtet për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit B. S. se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së prokurorisë. Kjo vërtetohet nga provat si vijojnë: Kallzim penal i datës 15.02.2021, nr.CMS-K/DMI-..., Procesverbalin e Keds-it me nr. Fotodokumentacioni, Faturën e sektorit të rikthimit të humbjeve e datës 13.11.2020.

Për gjykatën të gjitha këto prova janë bindëse dhe pa mëdyshje e vërtetojnë fajësinë e të pandehurit Bedri Surdulli, për kryerjen e veprës penale nga neni 314 par 6 të KPRK-së.

Gjithashtu vërtetohet se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje ligjore apo faktike, nga gjitha këto arsye gjykata vlerëson se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata në përputhje me nenin 69, 70 , të KPRK-së, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, mori për bazë gjendjen materiale dhe kushtet ekonomike të të akuzuarit si dhe vlerësoj se një dënimi i tillë i kushtëzuar është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e tij ekonomike, dhe me këtë dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPPK-ës e po ashtu dënimi i shqiptuar është në proporcion me vlerën e mbrojtur.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësor gjykata e morri në përputhje me nenin 450 të KPRK-ës.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 101/21 dt. 08.03.2021

Procesmbajtësja
Xheneta Kurti

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të parashtroj kundërshtimi në afatë prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim të këtij aktgjykimi, kundërshtimi i derjtohet kesaj gjykate.